



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 679/5 Prot

Tiranë, më 16.11.2020

**V E N D I M**

**Nr. 148, datë 16.11.2020**

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë, filluar në bazë të ankesës së paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\* , në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2020, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, institucioni Bashkia Kamëz.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet për vlerësimin e rezultateve në punë në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, të nëpunësit \*\*\*\*\* ,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet shkresës me nr. 679 prot., datë 11.09.2020 është protokolluar ankesa e nëpunësit \*\*\*\*\* , përmes së cilës ngrihen pretendime se, niveli i vlerësimit i dhënë për periudhën janar-qershor 2020, nga eprori i tij është kryer në mënyrë subjektive dhe në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të përmendura në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist Jurist*”, pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, Bashkia Kamëz, në datë 10.08.2020, është njohur me vlerësimin “*jo kënaqshëm*” të rezultateve në punë, për periudhën janar – qershor 2020, të kryer nga eprori i tij i

drejtpërdrejtë, Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, të kësaj bashkie.

Nga ana e nëpunësit pretendohet se, gjatë procesit të vlerësimit të sjelljes profesionale të nëpunësit civil, zyrtari raportues nuk ka patur parasysh gjithë kriteret për një vlerësimin objektiv, të parashikuara në kreun 2, pika 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, që kanë të bëjnë me gabimet/saktësinë në punën e kryer; realizimin në kohë të punës; kolegjalitetit të marrëdhënies; gadishmërisë për punën në grup; kërkesave për këshillim; aftësitë menaxheriale për nëpunësin, gjë e cila provohet me faktin se, në formularin e vlerësimit vihet re mungesa e komenteve/spjegimeve të zyrtarit raportues, në të gjitha rubrikat përkatëse.

Gjithashtu, pretendohet se, nga ana e zyrtarit raportues nuk janë respektuar fazat përmes së cilave kalon procesi i vlerësimit të rezultatit në punë të nëpunësit, sikurse janë planifikimi; bisedimet e ndërmjetme; vlerësimi përfundimtar i rezultatit në punë, të parashikuara në kreun 2, pika 12, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave.

Në këto rrethana, pas njohjes me rezultatin e vlerësimit, punonjësi \*\*\*\*\* ka refuzuar të firmosë formularin e vlerësimit si dhe ka paraqitur ankesë tek zyrtari autorizues në mbështetje të kreut 5, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, e cila është protokolluar me nr. 6625 prot., datë 31.08.2020, pranë Bashkisë Kamëz, për të cilën pretendon se nuk ka marrë ende një përgjigje nga ky institucion.

Nisur nga këto pretendime, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me parashtrimin e fakteve të mësipërme, me shkresën nr. 679/1 prot., datë 23.09.2020, me objekt: “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e ankesës së nëpunësit \*\*\*\*\*”, kërkoi nga institucioni Bashkia Kamëz, sqarime si dhe praktikën shkresore që disponojnë për këtë rast, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e institucionit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 7434/1 prot., datë 28.09.2020, me objekt: “Kthim përgjigje”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 679/3 prot., datë 02.10.2020, ka paraqitur sqarimet si dhe dokumentacionin e kërkuar për rastin në fjalë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, rezultoi se punonjësi \*\*\*\*\* ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin, me Urdhrin “Për emërim në detyrë”, nr.288, datë 24.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, në pozicionin e punës “Specialist Jurist”, pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, të kësaj Bashkie, me një periudhë prove dy (2) mujore, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen

*vendore*”. Më tej, nga ana e institucionit nuk është ndjekur asnjë procedurë për të plotësuar këtë pozicion pune sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, fakt i cili provohet nga përmbajtja e dosjes personale të këtij punonjësi, në të cilën nuk gjendet asnjë dokumentacion që të provojë pranimin e tij në shërbimin civil sipas kërkesave të dispozitave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse.

Në mbështetje të parashikimeve ligjore, e konkretisht, në bazë të pikës 7, të nenit 19, “Klasifikimi”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicioni “Specialist”, në Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike në Bashkinë Kamëz, klasifikohet në pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive dhe nisur nga kjo, sipas nenit 22 e vijues të ligjit në fjalë, pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur, sipas rregullave të hollësishme, të parashikuara në dispozitat e mësipërme dhe në vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, që parashikon në mënyrë të hollësishme procedurën e pranimit në shërbimin civil, të lëvizjes paralele, të emërimit dhe periudhën e provës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, ku përfshihet edhe pozicioni i punës “Specialist”, në bashki.

Më tej, procedura e pranimit në shërbimin civil organizohet nga njësi përgjegjëse e njësisë së qeverisjes vendore, për kategorinë ekzekutive, bazuar në planin vjetor të pranimeve dhe në bazë të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çdo emërim i kryer në kundërshtim me këto dispozita ligjore është absolutisht i pavlefshëm.

Referuar sa më lart, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen personale të punonjësit \*\*\*\*\* , Urdhri “Për emërim në detyrë”, nr. 288, datë 24.09.2018, (nr. 288 prot., datë 24.09.2018), në pozicionin “Specialist Jurist”, në Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, i Kryetarit të Bashkisë Kamëz, është një urdhër i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar në dispozitat ligjore që rregullojnë pranimin në shërbimin civil, në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, gjë që në bazë të pikës a/ii, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” e bën aktin absolutisht të pavlefshëm e për rrjedhojë, punonjësi \*\*\*\*\* , nuk mund të jetë pjesë e shërbimit civil. Në këto kushte, njësi përgjegjëse e institucionit bazuar në germën ç), të nenit 65, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të konstatojë pavlefshmërinë e aktit të emërimit për punonjësin \*\*\*\*\* , duke bërë njëkohësisht edhe ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil për këtë punonjës.

Në vlerësim të akteve ligjore dhe nënligjore përmendur sa më lart, arrihet në përfundimin se, punonjësi \*\*\*\*\*, me detyrë “*Specialist Jurist*”, pranë Bashkisë Kamëz, nuk gëzon statusin e nëpunësit civil, e për pasojë, në këtë rast nuk mund të aplikohen të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i institutit të vlerësimit të punës parashikuar në ligjin për shërbimin civil.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 108, pika a/ii, i ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, me synim rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë të konstatojë, pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 288, datë 24.09.2018, nëpërmjet të cilit punonjësi \*\*\*\*\*, është emëruar në kundërshtim me ligjin në pozicionin e punës “*Specialist Jurist*”, në Bashkinë Kamëz.
2. Të rregullohen pasojat duke e shpallur të lirë pozicionin e mësipërm, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10 ditë**, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Kamëz dhe punonjësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**